



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2019:080038

Datë: 30.04.2019

Numri i dokumentit: 00294936

P.nr.77/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN, gjyqtari **Sulltan Dobraj**, e me pjesëmarrjen e sekretares juridike Sabiha Hoxha, ne çështjen penale kundër te pandehurit J. I. për shkak te veprës penale sulmi nga neni 187 par.1 te KPRK-së, dhe veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1 të KPRK-ës, duke vendosur lidhur me aktakuzën e PTH-se nga Peja PP/II.nr.327/2019 të dt.14.03.2019, shqyrtimin fillestar te mbajtur me dt.**10.04.2019**, me pjesëmarrjen e Prokurorit te shtetit Ersan Qavolli dhe te akuzuarit, po të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri J. I., i lindur me dt...., i biri i R. dhe nënës N. e vajzërisë E., më numër personal ..., shqiptar, shtetas i Kosovës, gjendet ne liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se :

1.Me dt.03.02.2019 rreth orës 00:30 me dashje sulmon tjetrin dhe atë të dëmtuarin B.L. në atë mënyrë që gjersa i dëmtuari B. ishte duke punuar në pompën e derivateve "P..." pasi që vije i pandehuri J. i dehur në pompën e lartcekur e sulmon me veturë për ta goditur të dëmtuarin dhe me pas del nga vetura fillon të fjaloset më të dëmtuarin dhe prap e sulmon.

- **me çka ka kryer veprë penale sulmi nga neni 187 par.1. te KPRK-së,**

2. Më dt.03.02.2019 rreth orës 00:30 dëmton pasurinë e tjetrit dhe atë të dëmtuarës "P..." në atë mënyrë që i pandehuri kishte shkuar i dehur në pompën e benzinës "P... Company" për tu furnizuar me derivate, del nga automjeti dhe shkon te zyra e pompës dhe me këmbë e godet dhe e dëmton xhamin e këtij objekti.

- **me çka ka kryer veprë penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1. te KPRK-së,**

Andaj gjykata, konform nenit 7, 17, 21, 41, 45, 50, 51, 52, 53, 58, 73, 74, 80, 187 par.1. nën te KPRK-ës, dhe nenit 333 par. 1. të KPRK-ës, dhe neneve 365 dhe 453, 463 të KPPRK-ës, të akuzuarin e:

G J Y K O N
ME DËNIM ME KUSHT ME URDHËR PËR MBIKQYRJEN NGA SHERBIMI
SPROVUES

Për pikën 1 te dispozitivit i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj burg, të cilin dënim fare nuk do ta mbaj, nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

Për pikën 2 te dispozitivit i shqipton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj burg, të cilin dënim fare nuk do ta mbaj, nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër të re penale.

DËNIMI UNIK

Në bazë të nenit 80 të KPK-ës:

Gjykata të pandehurit i ka shqiptar dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj, me kusht, të cilin dënim fare nuk do ta mbaj, nëse në afat prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë vepër të re penale,

Gjykata i shqipton dënimin plotësues te pandehurit heqje dorë nga përdorimi i alkoholit.

I dëmtuari B. L. nga Deçani udhëzohet në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.

Urdhërohet shërbimi sprovues që ta mbikëqyrë ekzekutimin e dënimit me kusht të cekur me lartë.

Urdhërohet, i pandehuri që të mban kontakte me shërbimin sprovues, duke ja bërë me dije të pandehurit se në rast nëse i pandehuri nuk mban kontakte me shërbimin sprovues gjykata mund ta revokon dënimin me kusht.

I pandehuri lirohet nga shpenzimet e procedurës penale.

A r s y e t i m

PTH ne Pejë me aktakuzën **PP/II.nr.** 327/2019 të dt.14.03.2019, ka akuzuar J. I. për shkak te veprës penale sulmi nga neni 187 par.1. te KPRK-së, dhe veprës penale asgjësimi ap dëmtimi i pasurisë nga

neni 333 par.1. të KPRK-ës, ka propozuar të caktohet shqyrtimi fillestar kundër të njëjtit, të administrohen provat e duhura e me në fund i njëjti te shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, si dhe te ngarkohet me shpenzimet e procedurës penale.

Gjykata themelore ne Pejë Dega ne Deçan me dt.10.04.2019, ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar ku pas leximit te aktakuzës i pandehuri e ka pranuar fajësinë, te cilin pranim fajësie gjykata e ka pranuar me aktvendim ne procesverbal te shqyrtimit gjyqësor në baze te nenin 248 KPPPK-ës.

Prokurori në fjalën përfundimtare ka deklaruar se ky pranim fajësie mbështetet me provat materiale te cilat gjenden ne shkresat e lendes unë ne tersi mbetem pranë aktakuzës dhe cilësimit juridik te saj gjykatës i propozoi që i njëjti te shpallet fajtor dhe ta dënon ne bazë te ligjit, lidhur me vendimin për dënim si rrethanë lehtësuese te merr pranimin e fajësisë .

I pandehuri në fjalën përfundimtare deklaroi se: shpreh keqardhje, jam shumë i penduar, premtoi se ne të ardhmen nuk do te dehem më.

Gjykata me pranimin e fajësisë ne tërësi e ka vërtetuar këto gjendje faktike:

I pandehuri me dt. 03.02.2019 rreth orës 00:30 me dashje sulmon tjetrin dhe atë të dëmtuarin B. L. në atë mënyrë që gjersa i dëmtuari B. ishte duke punuar në pompën e derivateve “P... Company” në Deçan, pasi që vije i pandehuri J. i dehur ne pompën e lartcekur e sulmon me veturë për ta goditur të dëmtuarin dhe me pas del nga vetura fillon të fjaloset më të dëmtuarin dhe prap e sulmon.

Po ashtu i pandehuri me dt.03.02.2019 rreth orës 00:30 dëmton pasurinë e tjetrit dhe atë të dëmtuarës “P... Company” në atë mënyrë që i pandehuri kishte shkuar i dehur në pompën e benzinës “P... Company” për tu furnizuar me derivate, del nga automjeti dhe shkon te zyra e pompës dhe me këmbë e godet dhe e dëmton xhamin e këtij objekti.

Gjykata paraprakisht te pandehurit i ka sqaruar natyrën dhe pasojat e pranimin te fajësisë dhe e ka udhëzuar se me pranimin e fajësisë i njëjti do te shpallet fajtor për veprat penale te lartcekura, do ti shqiptohet sanksioni i paraparë me ligj, dhe se nuk do te këtë procedure te provave.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë që ka bërë i pandehuri për të dy veprat i cili i ka pasur te njohura natyrën dhe pasojat e pranimin te fajësisë, dhe ne mënyrë vullnetare, me vetëdije, pa ndonjë detyrim, mashtrim apo

lajthim e ka pranuar fajësinë për veprat penale të cilat i vihen ne barre, i cili pranim fajësie mbështetet në faktet e çështjes qe përmban aktakuza, ne materialet e

prezantuar nga prokurori i shtetit, dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore ose gabime faktike.

Gjykata duke u kujdesur zyrtarisht në kuptim të nenit 257 të KPP-ës nuk ka gjetur ndonjë prove të pa pranueshme dhe gjithashtu është vërtetuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë konform nenit 248 të KPP-ës, ndërsa pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, andaj kjo gjykate ka ardhur në përfundim se në veprimet e të pandehurit janë formuar të gjitha elementet e figurës së veprës penale të sulmit nga neni 187 par.1. të KPRK-së, dhe veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 333 par.1. të KPRK-ës, ka konstatuar se i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e ndërmarra, i ka dashur ato veprime dhe pasojën e shkaktuar e ka dëshiruar, për veprimet e tilla të cilat përmbushen elementet e veprave penale të lartcekura është përgjegjës dhe i përgjegjshëm për veprat penale, andaj gjykata ka vendosur dhe të pandehurin e shpall fajtor për veprat penale, pastaj i ka shqiptuar dënimin e kushtëzuar me burgim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe ka urdhëruar që dënimi me kusht të mbikëqyret nga shërbimi sprovues.

Gjykata në bazë të nenit 80 të KPK të pandehurit i ka shqiptuar dënimin për secilën veprë penale pastaj i ka shqiptuar dënimin unik me kusht me burgim për të dy veprat penale.

Gjykata ka vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit, shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, dhe në këtë mënyrë do të ndikoj në arritjen e qëllimit të dënimin që parashihet në nenin 41 të KPRK-ës, si mase për parandalimin e të pandehurit por edhe si mase për parandalimin e të pandehurit dhe personave të tjerë kryes potencial të veprave penale nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të shpreh gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata në bazë të nenit 73 dhe 74 të KPK me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e dënimin gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, të cilat mund të ndikojnë në lartësinë dhe llojin e dënimin ndaj të pandehurit. Kështu si rrethana lehtësuese gjykata ka gjetur se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për të dy veprat, sjelljet e mira gjatë gjykimin, pastaj kërkim falja nga ana e të pandehurit, pendimi i të pandehurit, i pa dënuar më parë ndërsa si rrethanë rënduese gjykata nuk e ka gjetur asnjë rrethanë.

Në bazë të nenit 58 të KPK gjykata të pandehurit i ka shqiptuar dënimin me kusht dhe ka urdhëruar që dënimi me kusht të mbikëqyret nga shërbimi sprovues, sepse ka konsideruar se integrimi i të dënuarit në shoqëri do të arrihet me

mirë përmes mbikëqyrjes nga ana e shërbimit sprovues, dhe ja ka bere me dije te pandehurit se është i obliguar te mbaje kontaktet me shërbimin sprovues, duke e njoftuar se ne rast se i shkëput kontaktet me shërbimin sprovues gjykata do te revokoj dënimin me kusht.

Ne baze te nenit 463 te KPPK gjykata e ka udhëzuar te dëmtuarin ne kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike sepse ne shkresat e lendes nuk ka gjetur ndonjë kërkesës te specifikuar ne baze te cilës gjykata do te mund te vendoste.

Gjykata e ka liruar te pandehurin nga shpenzimet e procedurës penale sepse ka konsideruar se i pandehuri është i gjendjes se dobët ekonomike dhe nëse ngarkohet me shpenzime te procedurës penale do ti rendohej edhe më tej gjendja e rëndë ekonomike.

Duke u bazuar ne te lartcekurat u vendos si ne dispozitiv.

**GJYKATA THEMELORE PEJË DEGA DEÇAN,
P.nr.77/2019 të dt.10.04.2019**

Sekretarja juridike

Sabiha Hoxha

G J Y Q T A R I

Sulltan Dobraj

KËSHILLA JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi lejohet ankesa në afat prej **15 ditësh** nga dita e marrjes, drejtuar gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2019:080038
Datë: 30.04.2019
Numri i dokumentit: 00294936